

## Titulli i lëndës: Letërsia dhe mediat (filmi)

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
Titulli i lëndës:	Letërsia dhe mediat (filmi)
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i II-të
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. asoc. Dr. Albulena Blakaj- Gashi
Të dhënat kontaktuese:	Tel: 038222970/ albulena.blakaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Letërsia dhe mediat (filmi) është lëndë që bën një pasqyrim të letërsisë dhe mediave, në këtë rast të filmit, si medime të përhapjes së ideve. Fillimisht bëhet një historik i librit si medium që nga fillimi, sidomos pas zbulimit të makinës së shtypit nga Gutenberg më 1450, e deri në shek 20. kur ishte mediumi kryesor me ndikim. Zhvillimi i filmit si teknikë në fakt ndodhë nga shek 19, por një ndikim në masa të gjëra e ka pasur nga fillimi i shek. 20. Kështu pasi bie interesimi për librin dhe teatrin dhe zëvendësohet me mediumin e ri- filmin, shkrimtarë të ndryshëm e marrin si sfidë përhapjen e letërsisë në masa të gjëra përmes filmit. Analizohen ndikimet e anasjellta të të dy mediave përmes shembujve të ndryshëm të filmimeve të veprave të njohura, apo të autorëve të njohur gjerman.

Qëllimet e lëndës:

- Lënda *Letërsia dhe mediat (filmi)* ka për objektiv fokusimin te letërsia dhe filmi si mediume të përhapjes së ideve dhe ndikimit,
- Të analizohen ndikimet e anasjellta të të dy mediave përmes shembujve të ndryshëm të filmimeve të veprave të njohura
- Njohja e studentëve me vepra të zgjedhura të autorëve të njohur gjerman të cilat janë filmuar, si dhe me shkrimtarë të ndryshëm që e marrin si sfidë përhapjen e letërsisë në masa të gjera përmes filmit.
- Njohja e studentëve me historiatin e filmit, mediumit që zëvendësoi interesimin për librin dhe teatrin me mediumin e ri

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të sukseshem te këtij kursi (lënde) studenti do të:

- dijë për letërsinë dhe filmin si mediume të përhapjes së ideve dhe ndikimit,
- dijë për ndikimet e anasjellta të të dy mediave;
- dijë për filmimet e veprave të zgjedhura të autorëve të njohur gjerman;
- zhvillojë aftësinë e krijimit të mendimit të pavarur rreth filmimit të një vepre letrare
- të jetë në gjendje ta shprehë mendimin e krijuar për një temë, vepër e film të caktuar;
- Të jetë në gjendje të shkruaj një punim krahasimtar për veprën dhe filmin e realizuar mbi bazën e romanit

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	15min	4	1
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	5	1	5
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja për provimin final	15	1	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.			
<b>Total</b>			<b>79.75:25= 3.19 3 ECTS</b>

#### Metodat e mësimdhënies:

Metodologjia e mësimdhënies do të jetë me studentin në qendër dhe interaktive. Realizimi i programit nga lënda *Letërsia dhe mediat (filmi)* bëhet edhe me pjesëmarrjen aktive të vet studentëve, të cilët qysh në fillim të semestrit të parë pasi ju dorëzohet programi përcaktohen për një temë për të cilën do të referojnë me ç'rast do të mësojnë edhe për punën e pavarur për mbledhjen e seleksionimin e materialit të nevojshëm për hartimin e një punimi. Gjatë orëve prezantohen seminarët dhe zhvillohet debat në klasë për temën, por shikohen edhe pjesë nga realizimet filmike të veprave letrare. Kështu, pjesëmarrja aktive e studentëve bëhet komponentë qenësore në arritjen e objektivave të lëndës dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

#### Metodat e vlerësimit:

Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%.  
Vijueshmëria e studentit 10%;  
Detyrat individuale të kryera në shtëpi 20%;  
Provimi final 70%.

## Literatura primare:

1. Ligjëratat të përgatitura nga prof. ass. dr. Albulena Blakaj-Gashi
2. Neuhaus, Stefan (Hrsg.): Literatur im Film: Beispiele einer Medienbeziehung, Verlag Koenigshausen und Neumann GmbH, Würzburg, 2008;
3. Gast, Wolfgang (Hrsg.): Film und Literatur. 2 Bände. Bd. 1: Grundbuch. Einführung in Begriffe und Methoden der Filmanalyse, Bd. 2: Analysen, Materialien, Unterrichtsvorschläge. Frankfurt a. M. 1993;
4. Paech, Joachim: Literatur und Film, J. B. Metzler Verlag, Köln, 1997;
5. Bohnenkamp, Anne (Hrsg.) Interpretationen- Literaturverfilmungen, Reclam, Ditzingen, 2012;
6. Beicken, Peter: Wie interpretiert man einen Film?, Reclam, Philipp, jun. 2004;)

## Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.